

Një dritare në diversitetin bimor të Europës

Prill 2009



Përdorimi i diversitetit bimor zgjeron përdorimin e produkteve bimore, mbështet zhvillimin dhe rritjen ekonomike.

Në sajë të EURISCO, çdokush i interesuar mbi resurset gjenetike bimore tani mund të hyjë në informacionin e më tepër se 1.1 milion mostrave të bimëve të kultivuara dhe specieve të egra të koleksioneve *ex situ* në 38 vendet e Europës.

EURISCO, “Unë zbuloj” në Greqishten e lashtë, është një Katalog i bazuar në Web i cili siguron informacion mbi koleksionet bimore *ex situ* në mbarë Europën. Ai aktualisht përmban ‘të ashtëquajtura’ të dhëna të pasaportës për më tepër se 1.1 milion mostra të diversitetit bimor të mbajtur në afro 250 institucione Europiane në 38 vende. Mostrat mbulojnë 1400 gjini dhe 8750 specie, ku përfshihen drithrat, foragjeret, specie barishtore dhe të egra, varietetet e fermerëve dhe linjat e seleksionuara. Këto mostra përfaqësojnë më shumë se gjysmën e aksioneve *ex situ* – ose të mostrave të bankave gjenetike – të ruajtura në Europë dhe afërsisht 19% të mbarë totalit botëror – një burim jashtëzakonisht i domosdoshëm për kërkuesit, seleksionerët e bimëve dhe të tjerëve të interesuar për ta përdorur këtë diversitet për mbështetjen e zhvillimit bujqësor. Përdoruesit mund të kërkojnë sipas bimëkulturave, taksonomisë, origjinës, gjeografisë, datës së pranimit, statusit të mostrës dhe kriterëve të tjera.

EURISCO është katalogu i parë rajonal i resurseve gjenetike bimore dhe tashmë po përdoret si një model për zhvillimin e iniciativave të ngjashme edhe jashtë Europës.

Origjina e EURISCOs

Biodiversiteti është i njohur si burim jetësor për zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor. Mjaft konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare kanë bërë thirrje për konservim dhe përdorim më të mirë të këtij diversiteti. Konventa mbi Biodiversitetin (CBD) i bën thirrje vendeve që të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit mbi konservimin dhe të mbështesin përdorimin e diversitetit biologjik.

Traktati Ndërkombëtarë mbi Resurset Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë dhe Plani Global i Veprimit për Konservimin dhe mbështetjen e Përdorimit të Resurseve Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë theksojnë nevojën për sisteme informacioni për të menaxhuar dhe bërë të shfrytëzueshëm informacionin mbi diversitetin e bimëve nga ku sigurohet mbështetja e ushqimit botëror.

Mjaft iniciativa, siç është Strategjia për Diversitetin Biologjik Europian kërkojnë akses në një informacion të tillë nëse ato synojnë të arrijnë qëllimin e tyre.

Në vitin 2000, Bashkimi Europian miratoi fondin e një projekti (EPGRIS), për të ndihmuar vendet Europiane që i përgjigjen këtyre kërkesave, Infrastrukturës Europiane të Informacionit mbi Resurset Gjenetike Bimore, për zhvillimin e inventareve kombëtare të Resurseve Gjenetike Bimore (RGB) si dhe për krijimin e një katalogu kërkues të koleksioneve *ex situ* në Europë – EURISCO.

Katalogu EURISCO u publikua për herë të parë në Shtator 2003, në fund të projektit; dhe që atëherë, gjatë fazës së parë, informacioni është rritur, sot janë afro një milion aksione, të mbajtura në zhvillim dhe ruajtje konstante në rrjet.



Njohuritë tradicionale dhe diversiteti kulturor, mbështesin përdorimin e diversitetit bimor në rrugë të ndryshme e për qëllime të ndryshme.

Kërkesa e sotme për më tepër produkte ushqimore të ndryshme, forcon përdorimin e një variacioni më të gjërë të diversitetit gjenetik bimor.



Si funksionon dhe kush mer pjesë

EURISCO ka disa elementë kryesorë. Së pari është adoptimi i të dhënave në standardin e kërkuar. Specialistët e informacionit të resurseve gjenetike të vendeve pjesëmarrëse kontribuan në zhvillimin dhe rregullimin e një serie deskriptorësh standarte për gjermoplazmën, deskriptorët e FAO / IPGRI dhe Deskriptorët e Pasaportës sipas Grup-Kulturave (DPGK). Përshtatja dhe aderimi në të dhënat standarte është një parakusht për ndarjen dhe kërkimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve të informacionit.

Elementi i dytë kryesor është kryerja e inventareve kombëtare të resurseve gjenetike të vendeve pjesëmarrëse në marrëveshjet e Konventës mbi Bio-Diversitetin (CBD). Çdo vend ka përgjegjësi të plotë dhe të drejta sovraane për të vendosur mbi vënien në përdorim, korrektësinë (në të gjitha detajet), sigurinë dhe transferimin e të dhënave të inventareve të tyre kombëtare. Elementi i tretë është rrjeti i personave kombëtarë të kontaktit, që sigurojnë lidhjen midis inventareve kombëtare dhe Katalogut EURISCO. Ata sigurojnë që informacioni i miratuar në inventaret e tyre kombëtare të transferohet në katalogun EURISCO. Së fundi, vetë Eurisco ka një infrastrukturë teknike që reflekton në të njëjtën mënyrë siç është bërë për SINGER–Sistem i hapur në rrjetin e informacionit për Resurset Gjenetike, që siguron akses në informacionin e koleksioneve për Resurset Gjenetike Bimore të mbajtura në kujdesin e Qendrave të Trajtimit të Informacionit (rrjeti i 15 qendrave të mbështetura nga Grupi Konsultativ mbi Kërkimin Bujqësor Ndërkombëtar).

Duke vështruar për të ardhmen

Në fazën e dytë, EURISCO do të fokusohet në sigurimin e mbështetjes ndaj inventareve kombëtare dhe të personave të kontaktit të tyre, do vazhdojë të përmirësojë korrektësinë dhe shkallën e informacionit të vlefshëm si dhe pasurimin e funksioneve. Gjithashtu do të tentohet ngritja e një sistemi informimi Europian që do të sjellë informacionin *ex situ* bashkë me atë *in situ* në një pikë hyrëse globale e cila lidhet me burime të tjera informacioni nëpërmjet serviseve Web. Inisiativa për të filluar aktivitete të ngjashme në rajone të tjera janë tashmë në vazhdim e sipër.

E ardhmja po ndërtohet duke ju siguruar të gjithë atyre që kanë nevojë akses në informacionin mbi diversitetin gjenetik të bimëve në të cilin ne mbështetemi për mirëqenien tonë si dhe me rritjen e ndërgjegjësimit për vlerën e resurseve gjenetike bimore për brezat e ardhshëm.



Foto kortezi/e ng: E. Bettencourt and S. Dias
Fletë palosjet janë përkthyer nga Belul Gixhari dhe redaktuar nga Halit Sulovari dhe Fetah Elezi